

**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR "Koko Auction House"SH.P.K.**

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare" i ndryshuar, sot, me dt. 18/04/2018 me vullnet të lirë, Ortaku:

1. Koço Kokëdhima, i biri i Theodhor-it lindur më 21.04.1959, në Qeparo, Himarë, banues në adresën Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Kati 8, Tiranë, pajisur me letërnjoftimin me nr. 028976599

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartoj këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**NENI 2
EMRI**

Emri i shoqërisë është "KoKo Auction House"shpk.

**NENI 3
FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaku do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

**NENI 4
SELIA**

Shoqëria e ka seline e saj në Tiranë, në Rr. "Ismail Qemali", Pallati 18, Kati 1, Nr. 3, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5
AFATI**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

**NENI 6
OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Kryerja e veprimeve te ndërmjetësimit apo veprimeve të tjera tregtare, në rrugë elektronike, sipas legjisacionit në fuqi, për shitjen e sendeve të luajtshme apo të paluajtshme, piktura, skulptura, krijime artistike të të gjitha llojeve dhe gjinive, dorëshkrime dhe botime, libra dhe periodike, koleksionet e ndryshme filatelite, numizmatike (medalje dhe monedha),



makina epoke, pajisje tradicionale pune, mjeshtërie dhe jetese, objekte te përdorimit te përditshëm ose atij ceremonial, me vlera artizanale, etnografike ose historike, stoli, antika, antikuarë, objekte dekoruese dhe objekte te tjera arti të çdo kohe;

Organizimin e ankandeve online dhe ankandeve fizik për veprat e artit ose te sendeve të çfarëdolloji që bëjnë pjesë në qarkullimin civil apo pasurive të paluajtshme;

Zhvillimi dhe zbatimi marrëdhënieve Franchising ne fushen e shitblerjes dhe ankandeve per objektet e artit; nenlicencimi i franshizmarresve nepermjet dhënis se te drejtave jomateriale, modelesh, idesh fitimi, programe marketingu, organizimi e njohuri te tjera te përshtatshme ne fushen e objekteve te artit, ne përputhje me përbajtjen e kontratave te nënshkruara per kete qellim;

Shitjen dhe blerjen e objekteve te artit dhe krijimeve artistike sipas legjislacionit në fuqi, apo shitjen dhe blerjen e sendeve te tjera, te luajtshme dhe te paluajtshme;

Hapje ekspozitash kombetare dhe nderkombetare;

Vlerësimin e objekteve te artit dhe krijimeve te tjera artistike sipas legjislacionit në fuqi, keshillime ne lidhje me keto objekte dhe kryerja e çdo aktiviteti te lejuar nga ligji qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e veprimitarise.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë dhe përbëhet nga nga 1 (një) kuotë e vetme e nënshkruar nga ortaku i vetëm.

Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjeherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do te rregullohet sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e shoqerise.

ORGANI ADMINISTRATIV NENI 9

Administrator i parë i shoqërisë është z. Koço Kokëdhima, pajisur me letërnjoftimin me nr. 028976599.

**THEMELUES
Koço KOKËDHIMA**

